



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Financave – Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance

Administrata Tatimore e Kosovës – Poreska Administracija Kosovo – Tax Administration of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo	
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije	
Ministry of Finance	
Administrata Tatimore e Kosovës / Poreska Administracija Kosova / Tax Administration of Kosovo	
Departamenti i Burimeve Njerëzore / Departman Ljudskih Resursa / Department of Human Resources	
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	11
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No	243
Data Datum Date	04/04/18
No. pages:	
PRISHTINË / A	

Datë: 04.04.2018

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregulloren Nr.21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil Administrata Tatimore e Kosovës rishpall:

### KONKURS I BRENDSHËM(AVANCIM)

**Titulli i pozitës:** *Drejtor i Departamentit të Lojërave të Fatit (1 pozitë)*

**Nr. i referencës së pozitës së punës:** BF/900/JP00032570

**Përgjegjësi mbikqyrëse:** Po

**I raporton:** zv.Drejtorit të Përgjithshëm për Funkcionet e Veçanta

**Pozita:** Pozitë e karrierës

**Orari i plotë i punës:** Po

**Koeficienti:** Dhjetë(10) plus shtesa e aplikuesahme

**Vendi i punës:** Prishtinë

#### Qëllimi i vendit të punës:

Qëllimi i themelimit të Departamentit të Lojërave të Fatit është që si autoritet i vetëm brenda TAK-së të administrojë me Ligjin për Lojërat e Fatit, duke menaxhuar në vazhdimësi statusin qeverisjen, menaxhimin, e të gjitha subjekteve afariste të licencuara për zhvillimin e aktiviteteve të lojërave të fatit përfshirë licencimet e reja, vazhdimin e licencave ekzistuese, refuzimin e licencave, zgjerimin e aktiviteteve (hapja e pikave të reja, ndryshim të adresave, organizimin e lojërave shpërblyese) etj.

#### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Shqyrtimi i kërkesave për licencë, përgatitja e rekomandimit për licencë për subjektet që i plotësojnë kriteret për ushtrimin e lojërave të fatit, rishikimi dhe tërheqja e licencës, dhe inspektimi i subjekteve të lojërave të fatit;
- Identifikimi i rasteve specifike të mos përmbushjes së obligimeve të tatimpaguesve në rastet kur operacionet e subjekteve nuk janë në pajtim me licencimet e aprovuara me qëllim rekomandimi të lëshimit të gjobave dhe përfundimisht revokimin e licencës;
- Koordinimi në drejtim të mbikëqyrjes së lokaleve afariste të subjekteve ekonomike që organizojnë lojërat e fatit, kontrollin e instrumenteve audio-video, kontrollin e librave afariste, pajisjeve, pjesëve të mjeteve ndihmëse për ushtrimin e lojërave të fatit;
- Koordinimi i aktiviteteve me regjionet përkatëse të TAK-se, si dhe bashkërendimi i aktiviteteve me Doganën e Kosovës, Policinë e Kosovës me qëllim të ndërmarrjes së aktiviteteve të përbashkëta në terren;

- Organizimi i takimeve me kryetarët e komunave si dhe me institucione të tjera për zbatimin e legjislacionit në fuqi, për matjen e distancave nga institucionet edukativo arsimore, fetare dhe kulturore;
- Pjesëmarrja në grupet punuese dhe organizimi i seminareve me subjektet e lojërave të fatit me rastin e ndryshimit të legjislacionit;
- Zhvillimi i pjesës së planit vjetor të licencimit dhe rregullimit si dhe monitorimi i progresit kundrejt asaj pjese të planit.

**Kërkesat/Kualifikimet Profesionale:**

Që të kryej këtë punë me sukses, një individ duhet të ketë:

- Diplomë universiteti ne Fakultetin Ekonomik, Juridik apo te Biznesit;
- 7 vite përvojë pune profesionale, përfshirës së paku 4 vite në pozitë drejtuese;
- Njohuri te lartë per legjislacionin qe zbatohet dhe administrohet nga Administrata Tatimore;
- Shkathtësi të lartë në menaxhim, organizim, caktimit të objektivave dhe planifikim;
- Njohuri të mira për mbikëqyrje efektive të punës profesionale të kryer nga vartësit;
- Shkathtësi të nivelit të lartë në komunikim dhe negocimit;
- Qasje fleksibile ndaj organizimit dhe mbikëqyrjes së punës, përfshirë zgjidhjen e problemeve;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

**Paraqitja e kërkesave:**

Aplikacionet mund të merren në Drejtorinë e Përgjithshme te Administratës Tatimore të Kosovës, e cila gjendet në adresën: Këndi i rrugëve "Bill Klinton" dhe "Dëshmorët e Kombit" p.n. në Prishtinë ose në web-faqen e Administratës Tatimore të Kosovës: [www.atk-ks.org](http://www.atk-ks.org) tek rubrika e punësimit.

Aplikacionet e plotësuara së bashku me kopje të dëshmimeve të kërkuara sipas Shpalljes për rekrutim dorëzohen në Drejtorinë e Përgjithshme të ATK-së- në Prishtinë ne Zyrën e Burimeve Njerëzore.

Aplikacionit duhet bashkëngjitur kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për këtë vend të punës, për të cilin konkurrioni.

**Konkursi është i hapur 8 ditë nga dita e publikimit nga data 04.04.2018 deri më 11.04.2018.**

Kerkesat e derguara pas dates se fundit nuk do te pranohen. Kerkesat e pakompletuara do te refuzohen. Per informata shtese mund te kontaktoni ne numrin e tel. 038/200 25022 .

